

STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"INTER STOCK Albania" sh.p.k.

Ne baze e ne zbatim te ligjit:

- Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" me poshte referohet si "Ligji Per Shoqerite";
- Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit";
- Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
Veprimtaria e shoqerise "INTER STOCK Albania" shpk
do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejten dokument me Aktin e Themelimit.

PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Ortaket

- 1.1 Personat juridike te meposhtem bien dakort per themelimin e shoqerise "INTER STOCK Albania" sh.p.k., dhe organizimin dhe funksionimin e kesaj shoqerie sipas ketij Statuti:

- **Shoqeria "AGNA" sh.a.**, person juridik i se drejtes tregtare Shqiptare, i regjistruar me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8827, date 14/12/1993 me seli ne Vrisera, Gjirokaster, me Numer Unik te Identifikimit et Subjektit (N.U.I.S)-it J62903631L, e perfaqesuar nga Administratori i saj **Z.Kristo NAÇI**, atësia Spiro, amësia Agllaia, shtetas Shqiptar, lindur më 28/04/1973, në Vrisera, Gjirokastër, mbajtes i leternjoftimit ID nr.034617347 dhe numer personal H30428035Q, banues në Dropull, me adresë Kakavie; Nd.031; H.0; Ap.0; Dropull i Sipërm; Kakavie; 6006; Dropull, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- **Shoqeria "INTER STOCK" sh.p.k.**, person juridik i se drejtes tregtare Kosovare, i regjistruar ne Ministrine e Tregetise dhe Industrise te Kosoves me Numer Unik Identifikues (NUI) 810853962, me date te regjistrimi 02.11.2015, me seli ne Zona Industriale p.n., 10000 Prishtine, republika e Kosoves, e perfaqesouar nga Drejtori Manaxhes (Administratori) i saj, **Z.Edmond KADRIU**, shtetas Kosovar, atesia Ruzhdi, amesia Sabernaze, lindur ne Prishtine, dhe banues po ne Prishtine, ne adresen Mehmet Akif Ersoy, Nr: 25, i identifikuar me karten e identitetit me numer te ID-se ID2608398, dhe numer personal 1019460343, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2
Emri i Shoqerise.

- 2.1 Emri i shoqërisë është **INTER STOCK Albania.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- 2.1 Emri tregëtar i shoqërisë është: **INTER STOCK Albania.**

Neni 3



Selia e Shoqërise

- 3.1 Selia e Shoqërise është në adresën: Autostrada Tirane –Durrës, Kilometri i Pare, Godina AGNA Group, Kati 1, kodi postar. 1001, Zona Kadastrale 2679, Nr. Pas. 122/30, Tirane, Shqipëri.

Adrese elektronike: spironaci9@gmail.com
Telefon: 00355 682061661

- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi shqiptar dhe atij të huaj si dhe vendimit të Asamblese së Ortakëve të shoqërise.

Neni 4 **Forma juridike e shoqërise.**

- 4.1 Shoqëria INTER STOCK Albania sh.p.k., është person juridik i te drejtës tregëtare shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 4.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Bisnesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
- 4.3 Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.
- 4.4 Shoqëria INTER STOCK Albania sh.p.k., ka një kapital i së cili ndahet në kuota, që do të derdhet nga ortakët sipas Nenit 7 të këtij Statuti, dhe që përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar (pakufizuar).

Neni 6 **Objekti i aktivitetit**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërise “INTER STOCK Albania” sh.p.k., është:

Hapja njesive tregëtare dhe atyre ndihmëse, për tregëtimin me pakice, të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të kepuceve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, si dhe çdo produkti tjetër të ngjashëm me përshkrimin e mësipërm. Çdo lloj veprimtarie tjetër tregëtare që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin.

PJESA II **KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT**

Neni 7 **Kapitali i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali i shoqërise është 1.000.000 Leke (një milionë Leke), i marrë përsipër dhe i nënshkruar nga ortakët e shoqërisë.

- 7.2 Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota, te cilat zoterohet nga ortakët e shoqërisë si më poshtë:

Ortaku	Kuotat e zoteruara	Vlera në Leke	Përqindja(%) ne kapital
AGNA sh.a.	1	510.000	51%
INTER STOCK sh.p.k.	1	490.000	49%
Totali	2	1.000.000	100%

- 7.3 Kapitali themeltar është vetëm në monedhën Shqiptare, në ALL. Kontributi i kapitalit mund te paguhet edhe ne monedhe te huaj, por do te vleresohet ne Leke me kursin e zyrtar te publikuar nga Banka se Shqiperise ne daten e mbritjes se shumes ne llogarite bankare te shoqerise.
- 7.4 Kapitali i nënshkruar do të derdhet nga ortakët në llogaritë bankare të shoqërisë jo më vonë se 30 ditë nga themelimi i shoqërisë dhe jo më vonë se 20 ditë nga regjistrimi i saj në regjistrin tregëtar(QKB).

III. STRUKTURA DREJTUESE **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT/ORTAKEVE**

Neni 8 **Përgjegjësia e kufizuar**

- 8.1. Ortaket janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet e saj.

Neni 9 **Të drejtat e lidhura me cdo kuotë**

- 9.1. Cdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve, me fuqi votimi ne perpjestim me % qe ka kuota e tij ne raport me kapitalin, dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10 **Fitimi dhe kalimi i kuotave**

- 10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a. kontibutin në kapitalin e shoqërise
 - b. shit-blerjes
 - c. trashëgimisë
 - d. dhurimit
 - c. cdo mënyrë tjeter parashikuar me ligjin Shqiptar.
- 10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, duke ruajtur te drejten e parablerjes se kuotave në radhe te pare ne favor të ortakeve te shoqërise dhe ne radhe te dyte ne favor të ortakëve/aksionere te shoqerive themeluese. Kapercimi i ketij kushti ben te pavlefshem kalimin e kuotave te persona te trete.

Neni 11
Detyrimet e Ortakëve

- 11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen-njoftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës. Secili prej Ortakëve, gjate seancave të mbledhjeve mund të kete me vete edhe nje specialistm te fushes, per tu keshilluar, ne vartesi te specifikimeve te rendit te dites, te Asamblese se Aksionereve.

PJESA IV
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12
Të drejtat e asamblesë së pergjithshme

- 12.1 Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët zotërues të kuotave.
- 12.3 Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - (c) emerimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - (d) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
 - (f) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - (g) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - (h) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit jashte vendit;
 - (i) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
 - (j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - (k) miratimin e raporteve vjetore dhe pasqyrave financiare të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - (l) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
 - (m) të vendosë për investimet;
 - (n) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
 - (o) të përcaktojë parimet e pergjithshme të politikave të shoqërisë;
 - (p) të caktojë shpërblimet për administratorin, të përfundojë kontratat e punës me administratorin dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
 - (q) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
 - (r) emërimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - (s) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertët kontabël;
 - (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori;
 - (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes së asamblesë;
 - (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
 - (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;

- (y) miratimin e cdo cështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin shqiptar dhe këtë Statut.
- (z) Marrjen e huave në emër të shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë .
- (aa) Lidhjen e marrëveshjeve për dhënien e huave.

12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

12.5 Asambleja e përgjithshme do të miratojë të gjitha vendimet me shumicën e thjeshtë të votave të hedhura në një Asamble të ortakëve të thirrur, përveç rasteve sikur në vijim, për të cilat do të nevojitet vota unanime e asamblesë:

- (i). Amendamenti i Statutit;
- (ii). Ndryshimi i vlerës së kapitalit të Shoqërisë, rritja apo zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë dhe shpërndarjes së kuotave të pronësisë mes ortakëve ose pranimi i Ortakeve të rinj;
- (iii). Shpërbërja e shoqërisë ose fillimi i likuidimit;
- (iv). Bashkimet me shoqëri të tjera;
- (v). shitjen, qiranë, pengun, hipotekën ose transferimin ose disponimin tjetër të pasurive/aseteve të shoqërisë të cilat përbëjnë prej pesëdhjetë e një për qind (51%) ose më shumë të vlerës totale të asetëve të Kompanisë;
- (vi). Hapja e filialeve ose degëve nën pronësi të plotë të Inter Stock Albania sh.p.k., jashtë territorit të Shqipërisë;
- (vii). Lidhja e ndonjë moratoriumi ose marrëveshjeje me kreditorët (bankat komerciale);
- (viii). Blerja e aksioneve në kompani të tjera;
- (ix). Marrja e një zotimi kapital, hyrja në ndonjë marrëveshje kredie ose kryerja e ndonjë zotimi që përfshin ndonjë shpenzim kapital mbi 50,000 EUR në emër të shoqërisë Inter Stock Albania sh.p.k.;

12.5 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi për perfaqesimin e ortakëve nga persona të trete, ose ortakët e tjerë, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

12.6 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 13

Vendimet e asamblesë së përgjithshme

13.1 Vendimet e renditura përta i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, percaktimi i politikave tregtare të shoqërisë, planeve dhe strategjive të biznesit, kryerja e investimeve të pa parashikuara, organograma shpërblyerjet dhe pagat për punonjësit, miratimi i pasqyrave financiare, marrja e huave dhe/ose kredive, percaktimi i njesive të shitjeve, riorganizimi i shoqërisë, ndryshimi i formës juridike të saj, likuidimi i shoqërisë, perfaqesimi në gjykata të ndryshme të shoqërisë, merren me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 14

Thirrja e asamblesë së përgjithshme

14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratori të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër. Njoftimi me shkresë, me fax apo me mesazh elektronik duhet

të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 21 (njetete e nje) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Adresat e kontaktit per dergimin e njoftimeve ortakeve, do te jete:

- Per ortakun AGNA sh.a. kristonatsi@agnagroup.com,
- Per Ortakun Interstock sh.p.k. edmond@numerouno-ks.com

Ne rast ndryshimi te adresave te njoftimit, ortaket duhe te njoftojne menjehere Administratorin e shoqerise INTER STOCK Albania sh.p.k..

- 14.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, qe mbledhja te zhvillohet dhe jane te informuar dhe te gatshem për të marrë vendime mbi rendin e dites, pavarësisht parregullsisë.
- Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 20% (njetetë për qind) të totalit të votave në Asamblene e Ortakeve të shoqërisë mund t'i drejtoj administratorit një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur Asamblenë. Në kërkesën drejtuar administratorit mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës. Pas marrjes së kerkeses, jo me vone se 15(pesëmbëdhjetë) ditë, administratori është i detyruar të njoftojë thirrjen e asamblesë.
- 14.3 Asambleja e Ortakeve, do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, mail, telexi, mezazhi elektronik apo faksi jo më pak se 21 (njetete e nje) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e Asamblesë së Ortakeve do të tregojë datën, kohën, mënyrën dhe vendin/platformën elektronike të takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në Asamblenë e Ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 15

Kuorumi. Vendimet e marra në Asamblenë e Ortakeve

- 15.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Pergjitheshme te Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kapitalit.
- 15.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, si dhe atyre te percaktuara ne Nenin 13, te ketij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë $\frac{3}{4}$ e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, videokonferencë, videocall, e.t.j., sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji, me miratim.
- 15.2 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Ortakeve.

- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblesë, të cilet do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e Asamblesë së Ortakeve thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.
- 15.5 Nëse edhe pas thirrjes sipas pikes 15.4 të Nenit 15 nuk harriet pjesëmarrja sipas pikes 15.1 të këtij Neni, atëherë asambleja do të thirret përsëri, në përputhje me pikën 15.4 të Nenin 15. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicë të thjeshtë apo të kualifikuar (sipas objektit të ceshtjes) të pjesëmarrësve në asamble.
- 15.6 Ortaket kane të drejtë të perfaqësohen dhe të perfaqësojnë në asamblenë e përgjithshme nëpërmjet Prokurave të Posacme dhe/ose Autorizim të thjeshtë të cilat duhet të depozitohen në sekretarinë e shoqërisë përpara datës së mbajtjes së mbledhjes.
- 15.7 Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, emerimin dhe shkarkimin e administratorëve, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqërisë, shnderimin në një formë tjetër, emerimin e likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, dhe percaktimeve të tjera të Nenit 13, vendos me tre të katërtat të votave të të gjithë ortakëve të shoqërisë, të cilet mund të votojnë me shkresë dhe sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".
- 15.8 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës në asamblenë e përgjithshme, për të gjitha ceshtjet që përmenden në Nenin 81 të Ligjit 9901 datë 14/04/2008 me përjashtim të ceshtjeve të përmendura në paragrafin më lartë dhe përjashtimeve të percaktuara nga Ligji i mesipër, si p.sh.
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) vendime për zhvillimin normal të veprimtarisë;
 - c) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë, e.t.j.

Neni 16 **Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakeve**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato ceshtje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblesë. Diskutimet mbi ceshtje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre për ndryshimin e rendit të ditës.

Neni 17
Procesverbali i mbledhjes së asamblese së përgjithshme

- 17.1 Për çdo mbledhje të asamblese së përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande dhe/ose postë elektronike jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18
Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shumë administratorë, të cilët do të përfaqësojnë Shoqërinë së bashku ose secili veç e veç. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratori, ka të drejtë dhe kompetencë të autorizojë punonjësit e shoqërisë dhe/apo punonjës të palë të treta të personave juridikë apo fizikë që t'i përfaqësojnë ata dhe shoqërinë në transaksione ekonomike-financiare-juridike-etj për të cilat nuk ka kufizim në këtë Statut, në legjislacionin Tregëtar dhe atë Civil.
- 18.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të veç e veç ose së bashku. Asambleja e ortakëve mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këto drejta.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë në bankat e nivelit të dytë, si dhe marrjen e kredencialeve për përdorimin e të gjitha shërbimeve on-line si e-banking për kryerjen e pagesave dhe të tjera shërbime, me të njëjta të drejta - detyrime dhe/apo kufizime sikur këto shërbime do të kryeshin përpara punonjësit të sportelit fizik të bankës.
 - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;

- (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënie dhe marrjen e paradhënies;
- (f) dhënie e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- (g) propozon punesimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit dhe në rast të miratimit të propozimeve prej Asamblese së Ortakeve, nën procedurat perkatese.
- (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre; administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqi ato, të nënshkruaj marrëveshje gjyqësore, të mbylli marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqi paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet, sipas përcaktimeve të Asamblese së Ortakeve të shoqërisë;
- (i) administratori ka të drejtë marri cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (k) administratori është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (l) administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dëkka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i Asamblese së Ortakëve;
- (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (o) administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (p) ndryshimin e të dhenave të kontaktit të shoqërisë;
- (q) hapjen dhe mbylljen e selive të adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit brenda territorit të Shqipërisë në vartësi të vendimeve të Asamblese të Ortakeve.
- (r) Vendos pezullimin e perkohshëm të aktivitetit të vecanta të shoqërisë.
- (s) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e perditsëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.
- (t) Administratori është i autorizuar të nënshkruajë cdo aplikim, formular, kerkese, ankese, etj, për llogari të ortakëve/pronareve pesona juridike apo fizike, me pronesi direkte apo indirekte, në lidhje me të dhenat e nevojshme dhe të detyrueshme nga legjislacioni shqiptar për cdo institucion publik apo privat, të tilla si, njohja dhe regjistrimi i pronarit perfitues, rezidencave tatimore të tyre, dhe cdo të dhënë tjetër të nevojshme për njohjen dhe indtifikimin e subjektit/personit/klienti, nga bankat, etj financiare, dhe cdo institucion që ka të bëjë me mbarevajtjen e aktivitetit të shoqërisë.
- (u) Administratori ka të drejtë të kryejë veprime të administrimit të „veçante“ vetëm kur është autorizuar në mënyrë të posaçme me Vendim të Asamblese të ortakëve të shoqërisë, të tilla si:

1. Leshimi, në çfaredo lloj forme i garancive ndaj të tremeve me asete ose pasuri të shoqërisë, vendosje e aseteve dhe pasurive të lajteshme ose jo, pasuri të shoqërisë si garanci bankare, nënshkrimin e kontratave të kredive ose çfaredo kontrate që nuk përmban shuma ose detyrime të cilat nuk janë në vlera ose obligime normale të objektit dhe veprimtarisë ekonomike të shoqërisë.

2. Blerjen dhe shitjen e pasurive te paluajtshme, te luajtshme te regjistruara per dhe ne emer te shoqerise.

3. Transferimin e patentave, markave dhe pronesi intelektuale te cfaredolloji.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

- 18.6 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, të Vendimeve të Asamblese së Aksionereve, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe/ose ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 18.7 Administratori do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të shoqërisë dhe do të përfaqësojë shoqërinë në mënyrë të pavarur, me përjashtim të çështjeve të renditura në 18.7.1. kur Administratori duhet të marrë edhe neneshkrimin ose konfirmimin e Administratorit tjetër, konfirmim ky, i dërguar nga adresa elektronike (email) zyrtare e Administratorit tjetër,
- 18.7.1 a. Nënshkrimi, ndryshimi ose përfundimi i një marrëveshjeje materiale që nuk është parashikuar në planin e biznesit;
- b. Ndryshime të pagave ose kushteve të tjera të punësimit të cilat nuk janë të parashikuara në planin e biznesit;
- c. Dhënia e bonuseve dhe beneficioneve për çdo punonjës të cilat nuk janë të parashikuara në planin e biznesit ;
- d. Marrja e një zotimi kapital, hyrja në ndonjë marrëveshje ose kryerja e ndonjë zotimi që përfshin çdo shpenzim kapital 10.000,00€ (dhjetë mijë Euro) nga likuiditetet e shoqërisë;
- e. Lidhja ose ndryshimi në çdo aspekt i ndonjë marrëveshjeje ose kryerja e ndonjë angazhimi që nuk mund të ndërpritet pa kompensim në çdo kohë me njoftim tre muaj ose më pak ose që nuk është në rrjedhën e zakonshme të biznesit ose që përfshin ose mund të përfshijë totalin vjetor shpenzime mbi 50.000,00€ (pesëdhjetë mijë Euro).
- 18.8 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm duke ruajtur në çdo rast interesat e shoqërisë.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) l ejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

e) kryen veprime në kundërshtim me statutin apo me vendimet e Asamblese së Ortakëve të shoqërisë.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditë duhen të ngrihen brenda tre vjetëve nga kryerja e shkeljeve ose nga zbulimi i tyre.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

- 18.9 Personat i identifikuar më poshtë do të caktohen **Administrator** dhe **Administratori tjetër**, i shoqërisë për një periudhë 5(pesë) vjetecare duke filluar nga dita e nënshkrimit të këtij statuti dhe akti themelimi, me të drejtë ripërtëritje:

Administratori i shoqërisë do të jetë:

-**Z. Spiro NAÇI**, shtetas Shqiptar, atesia Vasil, amesia Martha, i datelindjes 31/03/1997, lindur në Greqi e banues në Gjirokaster, Koca, 02040043, ndertesa Nr: 42, Hyrja Nr: 1, Dropull i sipërm, Kakavije 6006, i identifikuar me kartën e identitetit me numer 033128830 dhe numer personal J70331020K, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar.

Administratori tjetër i shoqërisë do të jetë:

Z Edmond KADRIU, shtetas Kosovar, atesia Ruzhdi, amesia Sabernaze, lindur në Prishtinë, dhe banues po në Prishtinë, në adresën Mehmet Akif Ersoy, Nr: 25, i identifikuar me kartën e identitetit me numer të ID-së ID2608398 dhe numer personal 1019460343, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar.

- 18.10 **Administratori i tjetër** ka të drejtë të ketë qasje në çdo moment, në dokumentacionin financiar dhe ligjor të shoqërisë, pa asnjë kufizim, si dhe në çdo dokumentacion tjetër komercial të shoqërisë, përfshirë por duke mos u kufizuar në e-banking dhe çdo llogari bankare të hapur në emër të shoqërisë, e.t.j., por pa të drejtë të realizimit të pagesave.



- 18.11 Shoqëria me vendim të Asamblese së Ortakëve mund të ndryshojë kompetencat dhe kufizimet e Administratoreve të shoqërisë me vendim të thjeshtë.

PJESA VI **VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE, FITIMI DHE HUMBJET**

Neni 19 **Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një të Dhjetorit të vitit të regjistrimit.
- 19.2 Në fund të çdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - (b) përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
 - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve për miratim, së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm (nese është e detyrueshme nga legjislacioni apo kërkuar nga asambleja).

Neni 20 **Fitimi i Shoqërie**

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Hartimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë dhe dorëzimi i tyre pranë autoriteteve shtetërore do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, legjislacionit fiskal dhe atij tregëtar.

PJESA VII **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Neni 21 **Prishja dhe likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e asetëve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII



TE PERGJITHSHME

Neni 22

Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3 Ky statut, njekohesisht edhe akt themelimi, hartoet dhe nënshkruhet në 6 (gjashte) kopje origjinale, më 20/03/2025.

ORTAKET E SHOQERISE "INTER STOCK Albania"sh.p.k.

Per "AGNA"sh.a.

Kristo Naci
ADMINISTRATORI



Per "INTER STOCK"sh.p.k.

Edmond Kadir
ADMINISTRATORI

